



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	28 . 10 . 2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHOK	6521/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.853/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.853/2022 të datës 04.10.2022 e parashtruar nga ankuesi nga kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.853/2022 e datës 04.10.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 04.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5870/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet për njohje të së drejtas për harmonizim të koeficientit të pagës nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 11.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5870/2022 të datës 04.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 05.12.2013 në emër të ankuesit; Kërkesën me numër reference: 01-120/04-0088258/22 të datës 28.09.2022 të ankuesit; Përgjigjen në kërkesë me numër reference: 01-120/04-0088258 të datës 29.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore; Letërnjoftimin e ankuesit; Zarin e datës 30.09.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesën e datës 06.10.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 11.10.2022; Listën e pagave për muajin gusht dhe shatorë 2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Urbanizmit i datës 21.09.2012; Shkresa DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014; Kërkesën e datës 19.09.2022 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB; Përgjigjen e datës 30.09.2022 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB dhe kërkesën e datës 03.10.2022 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-MPB.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 05.12.2013 është i punësuar në pozitën *Shefi Sektorit të Urbanizmit*, në Komunën e Mitrovicës së Jugut me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5). I njëjti me datë 28.09.2022, parashtron kërkesë me numër reference: 01-120/04-0088258/22 të Menaxheri i Burimeve Njerëzore për harmonizim (ngritje) të koeficientit nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), ndërsa me datë 29.09.2022 Menaxheri i Burimeve Njerëzore përmes përgjigjes me numër reference: 01-120/04-0088258-2/22 njofton ankuesin se pozitat për udhëheqës të sektorëve çdo herë i ka shpallur dhe rekrutuar duke u bazuar në katalogun e titujve të vendeve të punës, të cilët janë me gradën 7, sipas koeficientit 7.5.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Këshilli ti njeh të drejtën e harmonizimit të koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5) sikurse të koleget e tjerë të cilët kanë pozitën e Udhëheqësit të sektorit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave* si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se organi i punësimit respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka unifikim të pagës për udhëheqësit e sektorëve pasi aplikohen koeficient të ndryshëm lidhur me këto pozita të kategorisë së njëjtë, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se Udhëheqësi i Sektorit për Buxhet dhe Financa ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit Për Financa dhe Zhvillim Ekonomik ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Tatimit në Pronë ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësja e Zyrës për Informim ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Administratash dhe Financave ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Komunitete dhe Kthim ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Sekretarisë së Kuvendit ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Personelit ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit Ligjor ka koeficient 9.5, ndërsa udhëheqësit e sektorëve të tjerë duke përfshirë edhe ankuesin si *Shefi i Sektorit të Urbanizimit* kanë koeficient 7.5 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte dhe konstatime, Kolegji vlerëson se aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve të së njëjtës kategori brenda të njëjtit institucioni është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.*

Nisur nga fakti se ankuesi ka qenë i emëruar në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht sipas nenit 14 të kësaj Rregullore pozita udhëheqës i sektorit përcaktohej si pozitë e nivelit drejtues një (1) me grada shtatë (7) të pagës, duke u evidentuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës (*i miratuar me datë 05.02.2015 i ndryshuar dhe plotësuar me 21.08.2018*), UNM/010 dhe gradë 7 të pagës. Ndërlidhur me këtë, si dhe bazuar në nenin 34 paragrafi 3 të të njëjtës rregullore, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore kanë qenë të detyruar që të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitave në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore dhe rrjedhimisht edhe me shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 10.11.2014, drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP kishte kërkuar nga Sekretarët e Përgjithshëm, drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe menaxherët e personelit të

institucioneve publike që të bëjnë harmonizimin e koeficienteve në përputhje me nivelin e pozitës dhe detyrat e punës, ku ndër të tjera është kërkuar që koeficienti i pagës për pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit* të vendoset koeficienti i pagës tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si me lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut me rastin e mos harmonizim të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañsisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë, kështu që Kolegji vlerëson së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.*

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.853/2022

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhmikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.